

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA GLLOGOC**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **611-26-5980-5-2-1**

Sa i përket tenderit për **“Ngjyrosje dhe suvatimi i hapsirave të brendshme të institucioneve shkollore**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj

DONI CONSTRUCT SHPK & NPSH STARLIN

NUI

812312750

Adresa

Azem Jashari, 11000, Podujevë, Kosovë

Vendi

Podujevë

Kodi postar

11000

Numri Telefonit

38345386762

Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj

Blendon Zeqiri

Adresa elektronike

blendonzeqiri2@gmail.com

Data e parashtrimt të ankesës

05.09.2026

Nënshkrimi dhe vula



**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Autoriteti kontraktues: **KOMUNA GLLOGOC**

ka publikuar keto njoftime

- 27.07.2026 njoftimin për kontratë
- 17.08.2026 afati për dorëzimin e ofertave
- 17.08.2026 procesverballi i hapjes së tenderëve
- 25.08.2026 B58- njoftim mbi vendimin e AK-së dhe letrat standarde
- 27.08.2026 Kërkese për rishqyrtim
- 28.08.2026 Vendim për pezullim të aktivitetit të prokurimit
- 28.08.2026 Refuzim nga AK - Kërkese për rishqyrtim
- 05.09.2026 Ankese në OSHP

5. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

6. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

7. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së.

Ne si Operatori Ekonomik " DONI CONSTRUCT SHPK & NPSH STARLIN " dhe pjesëmarrës dhe i përgjegjshëm, kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues më datë 28.08.2026, duke kundërshtuar vendimin e AK-së. AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim me vendimin e datës 28.08.2026, andaj parashtrohet kjo ankesë pranë OSHP-së .

8. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Nenet:1 , Autoriteti Kontraktues: **KOMUNA GLLOGOC**

Shkeljet e dispozitave janë si me poshtë :

Nenet e LPP-së:

Neni 1 - Qëllimi i LPP-se

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 40.9 i Rregullores për prokurimin publik 001/2022 (RPP) Nenet e LPP-së: Neni 7 (Trajtimi i Barabartë), Neni 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve),

Neni 41-Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (RROUP):

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

9. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datën 25.08.2026 kemi pranuar Njoftimin mbi

Vendimin e AK-se (B58), ku Grupi ynë i Operatorëve Ekonomik është eliminuar

me arsyetimin se ka mosperputhje prej 0.24 € ndërmjet Formularit të

Tenderit (19,876.00 €) dhe totalit të Paramasës

(19,875.76 €).

Ky vendim i Autoritetit Kontraktues është i kunderligjshëm për keto arsye:

Pretendimi ankimor 1.

Gabim teknik i rrumbullakimit (Formatimi i Excel):

Llogaritja e saktë e gabimeve njësi me sasi të perkatese ne Paramase jep vleren e saktë prej

19,875.76 € ($13,579.5 \text{ m}^2 \times 0.60 = 8,147.70$

dhe $3,125.1 \text{ m}^2 \times 0.60 = 1,875.06$). Vlera

prej 19,876.00 € e shfaqur në Formularin e Tenderit ka ardhur vetem si pasojë e mbledhjes së nentotaleve të shfaqura të rrumbullakosura automatikisht nga Exceli

($9,853 + 10,023 = 19,876$). Siq shihet qartë edhe në tabelën e Rekapitullimit të Paramasë

sonë, vlera e llogaritur përfundimisht është

19,875.76 €.

PARAMASA dhe PARALLOGARIA për kryrjen e punëve

Ngjyrosja dhe suvatimi i hapësirave të brendshme të institucioneve shkollore

1.PUNËT E SUVATIMIT					
Poz	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
1	Furnizimi me material dhe punimi i mureve të brendshme dhe pllafoneve me dy shtresa glet. Pas ngurtësimit sipërfaqja e gletit duhet të rrafshohet përmes grryrjes me makinë. Paraprakisht nga sipërfaqet e mureve duhet të gryhet ngjyra e pastaj të trajtohen me një shtresë bazë dhe një shtresë rrafshuese (lepak i bardh). Në çmim duhet të përfshihen edhe këndët metalike në rast nevojë.	m ²	100.0	2.50	250 €
2	Furnizimi me material dhe punimi i mureve të brendshme dhe pllafoneve me fasadë 1.0mm (në thas). Paraprakisht nga sipërfaqet e mureve duhet gryhet ngjyra e pastaj të trajtohen me një shtresë bazë dhe një shtresë rrafshuese (lepak i bardh). Në çmim duhet të përfshihen edhe këndët në rast nevojë.	m ²	2,435.0	2.80	6,818 €
3	Furnizimi me material dhe suvatimi i mureve të jashtme në pjesën e aneksit të njeve sanitare në shkollën Rilindja në Dobroshec. Suvatimi behet me suva të gatshme me trashësi rreth 1cm. Paraprakisht sipërfaqja trajtohet me bazë. Në çmim duhet të përfshihen edhe këndët në rast nevojë.	m ²	95.0	5.00	475 €
4	Furnizimi me të gjithë materialin e nevojshëm dhe punimi i fasadës së objektit P+0 Në shkollën Shaban Polluzha në Korroticë të Epërme, në ballin e objektit ku ka renë fasada ekzistuese, me termoizolim stirpor. Fasada duhet të realizohet me shtresat si në vijim: • Lyerja e murëve me bazë • Termoizolimi stirpor N4, t=10cm, ngjitet me ngjitës dhe ankerohet me tiplla 5copë/m2 • Rrjeta 155g/m2 dhe këndët plastike ngjiten me një shtresë ngjitës të bardh • Masë rrafshuese ngjitës i bardh me baze cemento • Lyerja e sipërfaqës me bazë • Fasadë me strukturë 1.5mm • Ngjyrosja -një shtresë bazë dhe ngjyrë me bazë silikon Në çmim duhet të përfshihen të gjitha elementet tjera të nevojshme.	m ²	110.0	21.00	2,310 €
Total 1:				9,853 €	

2.PUNËT E NGJYROSJES					
Poz	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
5	Furnizimi me material dhe lyerja e murëve të brendshme dhe pllafoneve të institucioneve shkollore me ngjyrë të bardhë. Para ngjyrosjes duhet të lyhet me një shtresë bazë. Ngjyrosja duhet të bëhet sipas udhëzimeve të prodhuesit. VËREJTJE: Paraparkisht duhet të mbulohen inventari dhe gjesendet. Elementet e sterpikura duhet të pastrohen para se ngjyra të thahet.	m ²	13,579.5	0.60	8,148 €
6	Furnizimi me material dhe lyerja e murëve të brendshme të institucioneve arsimore deri në lartësinë ku preket me dorë me ngjyrë të bardhë të plastikuar dhe rezistent ndaj ujit (ngjyrë që mund të pastrohet). Nuanca e ngjyrës caktohet nga organi mbikëqyrës. Para ngjyrosjes duhet të lyhet me një shtresë bazë. Ngjyrosja duhet të bëhet sipas udhëzimeve të prodhuesit. VËREJTJE: Paraparkisht duhet të mbulohen inventari dhe gjesendet. Elementet e sterpikura duhet të pastrohen para se ngjyra të thahet.	m ²	3,125.1	0.60	1,875 €
Total 1:					10,023 €

REKAPITULLIM		VLERA
Punët e Suvatimit		9,853.00 €
Punët e Ngjyrosjes		10,022.76 €
Rekapitullimi :		19,875.76 €

Siç shihet në ilustrimin e më sipërm (prerje nga Excel-i i Paramasë), nëntotali i Punëve të Ngjyrosjes shfaqet si 10,023 € për shkak të formatimit vizual (format pa dhjetore), ndërsa në rekapitullim vlera reale analitike e llogaritur nga Excel-i është 10,022.76 €. Kjo ka bërë që gjatë mbledhjes vizuale të shfaqet vlera 19,876.00 €, ndërsa në rekapitullim vlera e saktë është 19,875.76 €.

Pretendimi ankimor 2.

Shkelja e Nenit 40.9 të Rregullores Nr. 001/2022:

Mospërputhja prej 0.24 € përbën vetëm 0.0012% të vlerës totale të ofertës. Sipas Nenit 40.9 të Rregullores për Prokurimin Publik, për çdo gabim aritmetik që është nën fashën prej 2%, Autoriteti Kontraktues ka obligim ligjor të bëjë korrigjimin e gabimit aritmetik, të dergojë formularin B49 për konfirmim dhe të mbajë ofertën të vlefshme, e jo të vendosë eliminimin e saj.

Pretendimi ankimor 3.

Keqzbatimi i Nenit 40.10(b) dhe Nenit 59 të LPP-së:

AK-ja ka keqinterpretuar **Nenin 40.10(b)**, sepse sipas këtij neni dhe parimeve të prokurimit, çmimet njësi mbizotërojnë. AK-ja duhet të merret si bazë çmimet njësi të saktësuara dhe të kërkonte pëlqimin tonë për korrigjim, duke respektuar edhe **parimin e ekonomicitetit (Neni 6) dhe trajtimit të barabartë (Neni 7)**.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmenden më lartë, kërkojmë nga ju si AK që të aprovi kërkesën tonë për rishqyrtim:

PRA ,

Me këtë rast Autoriteti Kontraktues ka shkelur **Ligjin e Prokurimit Publik** , gjegjësisht **RREGULLAT dhe UDHËZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK**
neni 41 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

41.1 Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga OE do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do t'i epet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kriteret ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë procedurës së prokurimit.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë , kërkojmë nga Ju si AK që të aprovonit kërkesën tonë për ankimim :

VENDIM

APROVOHET , si e bazuar ankesa e OE:

DONI CONSTRUCT SHPK & NPSH STARLIN

ANULOHET , B58 NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK datë 25.08.2026

OBLIGOHET, KOMUNA GLLOGOC të kthejë lëndën në RIVLERËSIM dhe gjatë rivlerësimit të veprave sipas LPP si dhe RRUOPP.

10. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale dhe financiare do të vlerësohen dhe do të dokumentohen nga një ekspertizë profesionale dhe Neve si grup i Operatoreve Ekonomik na janë bërë dëme materiale për pagaditjen dhe dorëzimin e ofertes, për kërkesën për rishqyrtim dhe ankesën pranë OSHP-së andaj demet janë të konsiderueshme.

11. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*